




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. Br. Prot. 01-4915/15
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages 02	Data Datum 24.12.2015
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	23.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-4543/15
PËR/ZA/TO:	znj. Hajrie Shala - Gjykata Themelore në Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



E nderuara znj. Shala,

Lidhur me kërkesën tuaj të pranuar në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPK 03-02/4543/15), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (LPKI), Agjencia bënë *“këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprore, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”* (Neni 19, pika 1.5 e Ligjit nr. 04/L-051)

Kërkesa juaj ka të bëjë me sqarimin nga Agjencia kundër Korrupsionit, lidhur me situatën se a ka konflikt interesi në rastin kur mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit nga KEDS është avokati Besnik Berisha i cili, sipas juve, është edhe këshilltar i Kryeministrit të Kosovës.

Nga informacionet e siguruar nga Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, kemi vërtetuar se z. Besnik Berisha, nga data 30.04.2015, nuk është Këshilltar Politik i Kryeministrit.

Ndërkohë, nga e njëjta zyre, me datë 10.07.2015, pas kërkesës së Agjencisë, kemi marrë përgjigje se z. Berisha është i deleguar në Zyrën e Kryeministrit, tani në cilësinë e “Ekspertit për Zhvillim/ngritje të kapaciteteve”.

Andaj, z. Berisha, në cilësinë e Ekspertit për Zhvillim/ngritje të kapaciteteve në Zyrën e Kryeministrit, nuk është zyrtar i lartë publik dhe nuk i nënshtrohet dispozitave të Ligjit PKI (neni 4). Andaj ju këshillojmë që të veproni konform dispozitave të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit.

Me respekt!

